



Bashkia Berat

RELACION

PER BUXHETIN VJETOR 2020 DHE
PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM
PERFUNDIMTAR
2020-2022.



Pembajtja e Plan Buxhetit 2020 dhe PBA Perfundimtare 2020-2022

Mesazhi Kryetarit te bashkise Berat per buxhetin e vitit 2020

Hyrje

1 .Vështrim i përgjithshëm

1.1 Situata e njësisë së vetëqeverises vendore.....

1.2 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/vizioni/misioni/strategjia territoriale

1. 3. Objektivat e P/buxhetit te bashkise Berat per vitin 2020.....

1. 5 Informacion permbedhes per P/ buxhetin e vitit 2020 dhe PBA 2020-2022.....

2. Parashikimet buxhetore afatmesme 2020 – 2022.....

2. 1 Plani financiar i periudhes afatmesme 2020-2022.....

2. 2 Transferta e pakushtëzuar 2020.....

2. 3. Transfertat sektoriale 2020.....

2. 4. Transferta të kushtëzuara per funksione te deleguara.....

2. 5 Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.....

2. 6. Planifikimi i të ardhurave nga taksat &tarifat vendore per vitin 2020 dhe PBA 2020-2022

2. 7 Planifikimi I të ardhurat nga drejtorite e bashkise dhe institucionet e varësisë per vitin 2020 dhe PBA 2020-2022.....

3. Parashikimi i shpenzimeve për periudhën 2020 -2022

3. 1 Detyrimet e prapambetura dhe plani i shlyerjes se tyre

3. 2 Stuktura Financiare e Buxhetit 2020.....

3. 3 Planifikimi shpenzimeve sipas ndarjes ekonomike.....

3. 2 A. Planifikimi I Shpenzimeve korrente.....

A 1. Planifikimi I nr.te punonjesve.....

A 2. Planifikimi i shpenzimeve te personelit (paga dhe sigurime shoqërore).....

A 3. Shpenzimet operative, të mirëmbajtjes dhe shërbimeve publike

A 4. Shpenzimet për pagesat e principalit dhe interesit nga huamarrja. (kredia).....

A 5 . Shpenzimet për subvencione.....

A 6 Transferta tek organizatat dhe individë.....

A 7. Fondi rezerve, Fondi i kontigjences, fondi i emergjencave civile.....

3. 2. B Planifikimi i shpenzimeve kapitale (fondi I investimeve)

4. Planifikimi i shpenzimeve njesive shpenzuese dhe sipas programeve buxhetore

4. 1 Bashkia Berat (perfshi dhe Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpetimi).....



Bashkia Berat

- 4. 2 Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.....
- 4. 3 Ndërmarrja e Gjelberimit.....
- 4. 4. Drejtoria e Bujqesise, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave dhe Sherbimit Veterinar.
- 4. 5 Drejtoria Arsimore
- 4. 6 Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”.....
- 4. 7 Qendra “Lira”



MESAZHI I KRYETARIT TE BASHKISE BERAT PER BUXHETIN E VITIT 2020

I nderuar z. Ervin CECA, Kryetar I Keshillit te Bashkise Berat!

Te nderuar keshilltare!

Ne sjellim sot per miratim, Plan Buxhetin e vitit 2020 dhe PBA përfundimtare 2020- 2022, të hartuar ne mbështetje ligjore dhe llogjike ekonomike profesionale ne shërbim të komunitetit të Bashkisë Berat me moton :- Buxhet i Konsoliduar- Zhvillim i Qëndrueshem.

Me përmbajtjen e tij shprehin burimet reale të të ardhurave dhe mënyrën e përdorimit të fondeve të programuara.

Ai shpreh drejtimit kryesore të zhvillimit për periudhën e planifikuar dhe konsolidimin buxhetor të financave të Bashkisë Berat në një periudhë afat shkurtër dhe Afatmesëm, duke siguruar nëpërmjet konsolidimit një qëndrueshmëri ekonomike, me tre drejtime kryesore:

1- Shërbime Publike cilësore dhe të shtuara nga ana sasiore e tyre.

2- Vëmendje të plotë për Arsimin e Infrastrukturën e përmirësuar të tij, për një Berat - qytet të fëmijëve.

3- Zhvillim Kulturor mbi projekte të matshëm të artshëm dhe të realizueshëm në kohë me impakt të rëndësishëm social.

Si një dokument themlor në procesin e mirëqeverisjes Lokale, mbështetur mbi atë cka është bërë deri tani si dhe mbi dokumentat strategjik të hartuara në vite, ky buxhet ka pjesë të procesit dhe përmbajtjes së vet, objektivat e themelore dhe politikat ekonomike, programuar si pjesë e ndryshimit që do të pësojë bashkia në mirëqeverisjen e saj.

Shoqëruar nga Paketa e re Fiskale që tashmë kemi miratuar, nga kërkesa dhe domosdoshmëria për shërbime të shtuara, njohja e plotë e gjendjes financiare që trashëguam, analiza e plotë faktoriale e saj, Plan Buxhti shpreh dhe materializon:

1- Prioritetet e rëndësishme të cilat janë formëzuar krahas punës cilësore planifikuese dhe duke marrë në konsideratë nevojën , kërkesat dhe mëndimin e komunitetit për një bashkëqeverisje cilësore e në shërbim të tij.

2- Detajon përdorimin e fondeve të llogaritura sipas funksionit, qëllimit dhe objektivave që programon.

Plan buxheti 2020, në treguesit e investimeve është buxhet “ borxhesh” pasi mbulon faturat e investimeve të pa paguara gjatë vitit 2019 në vlerën **72.7** milion lekë, punimet që janë në proces të marrjes në dorëzim në vlerën **36** milion lekë dhe ristrukturon brënda kapaciteteve që ka vlerën **65** milion lekë planifikuar e miratuar për vitin 2020. Shuma e tepërcës Neto për investime e cila matematikisht për këtë plan buxhet do të ishte në shumën **173.7** milion kalon për investime të buxheteve të mëparshme dhe në terma real ky buxhet rezulton pa tepërcë neto operative.



Edhe pse në këto kushte, në vitin 2020 në bashkinë tonë do të kete investime nga puna që do të bëjme me punetorët e ndërmarrjeve tona, të përkthyer në lulishte të reja, bazë materiale për kopsht e cerdhe, shtrim rrugesh me asfalt e me cakull në të gjithë teritorin e bashkisë sikurse janë listuar në këtë buxhet.

Por jo vetem! Në kemi siguruar mbështetje nga donatorë e organizma botërorë për ta kthyer beratin në një kantier pune pasi jemi shpallur fitues real të shumë prej projekteve që kemi aplikuar e presim të fillojnë investimet dhe jo gjatë por në vitin 2020.

Gjatë vitit 2019 jemi përfitues në **Projektin për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turistik** financiar nga Banka Botërore.

Në harkun kohor 2020-2021 parashikohet financimi i Bankës Botërore në shumën **15 milionë dollarë** përfshirë TVSH. Projektet do të fillojnë në vitin 2020 dhe do të përfshijë:

- Restaurimin e peisazhit historik urban të Lagjes “Goricë”.
- Rehabilitimin urban të Sheshit “ Iljaz Vrioni”.
- Rigjenerim i zonës përreth Muzeut Etnografik dhe Rrugës “Mihal Komneno”.
- Restaurim dhe përdorim me përshtatje i ish- Selamllëkut të Vrionasve dhe zonës rrotull.
- Përmirësim pamor i siluetës urbane përgjatë rrugës “Antipatrea” në Qendër të Qytetit.
- Rehabilitimi i shtegut të Kalasë së Goricës dhe krijimi i potencialeve turistike pranë monumenteve dhe vendosje sinjalistike turistike dhe tabelat informuese për vizitorët.

-Do të vijojë Projekti “Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane” financiar nga **Qeveria Zviceriane** nëpërmjet Kooperimit Zvicerian. Pritet të fillojnë së shpejti ndërhyrjet pilot për depozitimin e mbetjeve ku dhe bashkia do të jetë financuese në vlerën e 18 milion lekëve nga të ardhurat e vitit 2020..

- Me *Fondacionin Shqiptaro Amerikan për Zhvillim* dhe Shoqatën *BID Berati* ka vijuar bashkëpunimi për Projekte në Zonën BID dhe në vitin 2020 do të zgjerohet aktiviteti edhe në Qendrën Historike .

-Me Bankën Gjermane për Zhvillim **KfE** vijon projekti i rehabilitimit të rrjetit ujësjellës- kanalizime Berat- Kuçovë.

-Me **PNUD** është bërë e mundur ngritja e Qendrës Komunitare për popullatën Romë dhe Egjiptiane dhe gjatë vitit 2020 do punohet me projekte mbështetese në Qendër për fëmijët në nevojë.

-Në kuadrin e Programit **Konkurrueshmëria IPA**, Berati do të jetë pjesë e financimit nga Delegacioni i BE dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH),për projekte infrastrukturore në funksion të rritjes së turizmit, në vlerë totale 10 milionë euro.

-Gjatë vitit 2019 është aplikuar dhe shpallur fitues projekti “ **E_ NATURE**” Programi IPA CBC Shqipëri- Greqi, financiar nga BE, për krijimin e shtigjeve turistike për biçikleta në rrethinat e Beratit. Vlera e buxhetit për Bashkinë e Beratit është 94,000 euro. Projekti do të fillojë në Janar 2020 dhe ka një shtrirje kohore prej dy vjetësh.



Bashkia Berat

-Shoqata Franceze e Menaxhimit të Ujrave **SICALA** ka bashkëpunuar me Bashkinë Berat për hartimin e Projekt- Idese për Menaxhimin e Lumit Osum sipas perspektivës Europiane. Ky Studim do aplikohet për financim në thirrjet e Programeve të BE.

-Shoqata **Franceze e Qyteteve të Artit dhe Historisë në Francë** do të vijojnë bashkëpunimin me Bashkinë Berat për Studimet dhe Projektet “ Menaxhimi i peisazhit historik dhe urban” dhe “ Eficenca Energjitike në Ndërtesat Historike”.

-Bashkia Berat ka aplikuar në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit dhe Ministrinë e Brendshme për programin e financuar nga BE “ **Thirrja e pestë e targetuar: Mbrojtja nga zjarri në pyje**” për financimin e disa mjeteve zjarrfikëse, blerje uniformash dhe pajisjesh të zjarrfikësve dhe rehabilitim të godinës së Sektorit të Mbrojtjes nga zjarri. Buxheti i Projektit është për t’u konfirmuar nga Sekretariati Teknik i Projekteve IPA në fillim të vitit 2020.

Duke krijuar bindjen e plote se ky Buxhet, tashmë në formatin e tij të plotë e ka në përmbajtjen e tij moton mbi të cilën është mbështetur : “Buxhet i konsoliduar, Zhvillim i qëndrueshëm”, shpreh mendimin se do të marrë dhe mbështetjen e Këshilltareve të këtij keshilli, për të kthyer kësaj Bashkie shpresën për ndryshim.

Ju faleminderit!

Ervin DEMO

KRYETAR I BASHKISË BERAT



HYRJE

Bashkia harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, të pavarur, i cili krijohet në mënyrën e parashikuar me ligj, pa defiçit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon administrimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “ Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin për financat vendore nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.7 date 27.02.2019 “ Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2020-2022 ”, ligjin nr. 139/ 2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 41 “Buxheti i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Program Buxhetor Afatmesëm”, që citon :

“Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë dhe miratojnë buxhetin vjetor e programin buxhetor afatmesëm, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon sistemin buxhetor dhe financat vendore. ”.

Programi buxhetor afatmesëm 2020-2022, ka si synim të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe territorial të bashkisë dhe të ofrojë shërbime me të mira për qytetaret.

Mbeshtetje e rëndësishme në procesin e përgatitjes së buxhetit janë të gjithë dokumentat

strategjike dhe vecanerisht Strategjia Territoriale, dokument që orienton zhvillimin

afatgjatë të bashkisë nëpërmjet shpërndarjes së drejtë të burimeve financiare duke prekur gjithë njësitet administrative të bashkisë Berat.

Buxheti vjetor dhe programi buxhetor afatmesëm është :

- ✓ Dokumenti që përmbledh tërësinë e të ardhurave, financimeve dhe shpenzimeve,

i miratuar nga Këshilli Bashkiak .

- ✓ Instrumenti më i rëndësishëm në menaxhimin e financave publike.
- ✓ Mjet komunikimi ndërmjet qytetarëve (komunitetit) dhe të zgjedhurve vendorë
- ✓ Dokumenti që lidh politikat e prioritetet nën kushtin e burimeve financiare të kufizuara për shpenzimet publike.
- ✓ Produkt i një bashkëpunimi të strukturave të brendshme, që lidhet me përgjegjësitë ligjore të punonjësve të Bashkisë dhe Njësive Administrative, ndërmarrjeve dhe institucioneve në varesi të saj.

Buxheti i vitit 2020 dhe PBA perfundimtare 2020 - 2022 tregojnë burimet e të ardhurave si dhe menyrën e shpenzimeve të fondeve.

Dokumentet e Programit Buxhetor Afatmesëm i referohet një strukturë të re, të thjeshtë, për ta bërë ato me të përdorshme nga Këshilli i Bashkisë dhe çdo përdorues tjetër i jashtëm.

1.1 Situata e njësive të vetëqeverisjes vendore

Bashkia e Beratit shtrihet në Krahinën Malore të Shqipërisë Jugore dhe pjesërisht në Ulëtirën Perëndimore në të dy anët e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të lumit Osum.

Me ndarjen e re administrative, Bashkia Berat, përfshin brënda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Beratit, njësitë Roshnik, Otlak, Velabisht dhe Sinjë.



Bashkia Berat

Sipërfaqja totale e Bashkisë Berat është 380 km², nga 22.4 km² që ishte para Reformës Administrative Territoriale 2014, nga e cila 170 km² është tokë bujqësore (ketu përfshihen tokat e kultivuara dhe jo të kultivuara) dhe 180 km² është tokë natyrore (pyje, kullota). Njësitë Otllak e Velabisht kanë përqendrimin më të lartë të tokës bujqësore e cila kryesisht kultivohet me dru frutore e ullinj e fidanishte. Njësia Sinjë e Roshnik karakterizohet nga tokë bujqësore e fragmentizuar e sipërfaqen më të madhe të tokës natyrore (reliev kodrinor e malor).

Bashkia Berat përshkohet nga lumi i Osumit dhe është tepër i pasur me ujë nentokësor e burime ujore sipërfaqësore. Sipërfaqja totale ujore është 9 km². Industria dhe ekonomia shtrihen në një sipërfaqe prej 1.34 km². Sipërfaqja që zëne shërbimet janë të përqendruara në qytetin e Beratit dhe fshatrat kryesore të katër njësive. Banimi shtrihet në një sipërfaqe të vogël, krahasuar me tokën bujqësore dhe natyrore, 4.63 km². Qyteti i Beratit karakterizohet nga zona urbane të konsoliduara. Në total bashkia Berat ka 812 km rrugë lineare. Bashkia Berat është qendra më e rëndësishme demografike, administrative dhe e ekonomike e qarkut Bërë.

Qyteti i Beratit gjendet 58 m mbi nivelin e detit dhe ka një sip. 22.4 km² nga e cila 6.3 km² janë sipërfaqe urbane. Ai pozicionohet:

- 125 km larg kryeqytetit të Shqipërisë dhe aeroportit nënë Terezë
- 92 km nga porti i Durrësit
- 85 km nga porti i Vlores
- 212 km nga porti i Sarandës
- 250 km nga pikat kufitare të Kakavijës dhe Kapshticës.

Tabela 1. Ndarja administrative e Bashkisë Berat

Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Sipërfaqja (km ²) ⁱ	Fshatrat/Qytetet në përbërje të tyre ⁱⁱ
Berat	Qyteti Berat	Berat	19 km ²	Qyteti Berat
		Otllak	52.7 km ²	Lapardha 1, Lapardha 2, Qereshnik, Balibardhë, Dyshnik, Moravë, Ullinjas, Vodëz e sipërme, Orizaj, Otllak.
		Velabisht	93.2 km ²	Malinat, Bilçë, Drobonik, Bardhaj i Ri, Starovë, Vetterik, Remanicë, Gjoroven, Palikësht, Veleshnjë, Duhanas, Kodras, Velabisht.
		Sinjë	138.5 km ²	Mbolan, Mjeshovë, Mbreshtan, Galinë, Sadovicë, Paftal, Kamçisht, Levan,



Bashkia Berat

				Velçan, Osmenez 1, Osmenez 2, Plashnik i Vogël, Molisht, Sinjë.
		Roshnik	78.7 km ²	Bogdan i Poshtëm, Bogdan i Sipërm, Dardhë, Karkanjoz, Kostren i Madh, Kostren i Vogël, Mimias, Perisnak, Qafë Dardhë, Vojnik, Rabjak, Roshnik Qendër, Roshnik i Vogël.

Berati njihet për arkitekturën, vlerat historike, kulturore, artistike dhe fetare. Është qendër ndërkombëtare e trashëgimisë kulturore (lagjet tradicionale të Mangalemit, Goricës dhe kalasë, Muzeu Kombëtar i Ikonografisë “Onufri” dhe galeritë tjera, muze, kishat, xhamitë). Historia 2400 vjeçare e bën atë ndër qytetet më të vjetër të vendit tonë. I shpallur “Qytet Muze” në vitin 1961 dhe aktualisht pjesë e listës të UNESCO-s si një qytet i Trashëgimisë Kulturore Botërore. Në skajin lindor të territorit të saj, bashkia ka një pjesë të Parkut Kombëtar të Tomorrit (2,416m), ndërsa në perëndim përfshin Malin e Shpiragut (1,218 m).

Sektorët kryesorë mbi të cilët mbështetet ekonomia e Bashkisë Berat janë bujqësia dhe turizmi. Ekonomia e qytetit të Beratit mbështet në shërbime.

Njësitë Otllak, Roshnik, Velabisht dhe Sinjë kanë ruajtur karakterin rural. Sektori kryesor i ekonomisë në këto njësi është bujqësia. Kultivimi i pemëve frutore, ullinjve dhe vreshtarisë është parësor në këto zona. Në Berat prodhimi i ullirit është në nivele të larta dhe është një nga produktet bujqësore të rëndësishme ku sipërfaqja e mbjelle me ullinj është 31.9 km².

Berati është zhvilluar si qendër rajonale për agrobiznesin, tregtinë dhe turizmin. Kjo si rrjedhojë e pozicionit gjeografik dhe aksesit me rrugët kombëtare.

Qyteti i Beratit ka si sektor kryesor ekonomik shërbimet, 66.9% është raporti i numrit të punësuarve në këtë sektor ndaj numrit të punësuarve gjithsej. Duke u pasuar nga industria me 29% dhe në fund bujqësia me 4.1 %. Njësitë Otllak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik kanë si sektor kryesor të ekonomisë bujqësinë. Në njësinë Sinjë dhe Roshnik punësimi në bujqësi me rreth vlerën 90%.

Njësitë Velabisht e Otllak janë dy njësitë të cilat kanë numrin më të lartë të bizneseve që ushtrojnë aktivitetin e tyre. Njësitë Roshnik është më pak e zhvilluar. Për sa i përket pikave të grumbullimit të produkteve bujqësore, në Bashkinë Berat ndodhen 2 pika nga të cilat 1 është në njësinë administrative Otllak dhe 1 në njësinë administrative Velabisht. Njësitë administrative Sinja dhe Roshniku, janë kultivuese të prodhimeve bujqësore, duhet të kenë pika të grumbullimit të këtyre produkteve.

Gjithsesi, procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit të brendshëm si dhe rënia e lindshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në ndryshimin drastik të struktursë së saj demografike, por edhe në rënie të numrit gjithsej të popullsisë.



1.2 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/ strategjia territoriale . **Orientimi afatgjatë i bashkisë**

Burimi i informacionit: PPV/PZhS

Vizioni strategjik, qe do te udheheqe zhvillimin e Bashkise se Beratit gjate 15 viteve te ardhshme”
"Berati eshte nje qytet i trashegimise kulturore boterore, me nje strukture te unifikuuar e te konsoliduar, urbane dhe rurale, me cilesi te larte jetese, i lidhur mire me zonat qendrore te Shqiperise permes nje infrastrukture moderne, si nje destination i fuqishem turistik dhe porte hyrese/pritesje per nje rajon te pasur natyror.

Nje nga asetet me me vlere te Bashkise Berat jane qytetaret e saj, ndaj rendesi e vecante i jepet nxitjes se kualifikimit te kapitalit njerezor, per te rritur integrimin e te gjitha qytetareve aktive ne tregun e punes.

Qëllimi kryesor: *harmonizimi i zhvillimit ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual të shoqërisë permes parimit te zhvillimit te qëndrueshëm të territorit.*

Misioni i bashkise ne funksion te ketij vizioni zhvillimi eshte:

Venia ne dispozicion ne menyre inteligjente e te gjitha burimeve financiare e njerezore per harmonizimin e interesave publike dhe private, per zhvillim ekonomik e social ne te gjitha territorin e Bashkise Berat.

Strategjia e zhvillimit të qytetit të Beratit është e përbërë nga gjashte objektiva strategjika .

Objektivi Strategjik 1: Orientimi i zhvillimit hapsinor me instrumenta inovativ te tokes me qellim strukturimin e hapsirës urbane në funksion të nxitjes dhe fuqizimit të një ekonomie të larmishme ne sektor dhe mjedis cilësor për komunitetin.

Objektivi Strategjik 2:

Zhvillimi i turizmit shume dimensional historiko-kulturor dhe eko/agrar ne nje mjedis te shendetshem, te qendrueshem e me vlere natyrore, si sektori baze ne zhvillimin ekonomik lokal dhe rritjen e mireqenies sociale te komunitetit.

Objektivi Strategjik 3:

Fuqizimi i aksesit brenda territorit te bashkisë si dhe bashkisë dhe nderlidhjes mes vendbanimeve e me kufitaret e e rajonit.

Objektivi Strategjik 4:

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë ne funksion te zhvillimit rural dhe uljes se papunesise.

Objektivi Strategjik 5:

Permiresimi i infrastruktures të sistemit arsimor dhe shëndetësor si dhe zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse të zbutjes se pabarazise sociale dhe ngritjes se



Objektivi Strategjik 6 :

Mbeshtetje e biznesit për të diversifikuar aktivitetin e tij dhe nxitja e sipërmarrësve të rinj me synim krijimin e një ekonomie lokale të qëndrueshme dhe konkurruese në rajon.

Në Programin buxhetor afatmesëm 2020-2022 do të gjejne mbështetje financiare prioritetet e kekesave të komunitetit të cilat janë përfshira në planet sektoriale të Bashkisë Berat dhe që do të trajtohen me poshtë.

Burimi i informacionit: PPV/PZhS; të tjera

1.3 OBJEKTIVAT E BUXHETIT TE BASHKISË BERAT PËR VITIN 2020

Programi buxhetor **2020-2022**, është një dokument planifikimi afatmesëm mbështetur në planin strategjik të zhvillimit, për të bërë të mundur realizimin e tij si dhe garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm, me objektiv primar: **permiresimin e cilësive të shërbimeve ndaj komunitetit.**

Përgatitja e buxhetit vjetor 2020 është pjesë përbërëse e procesit të programit buxhetor afatmesëm 2020-2020, ku buxheti vjetor është viti i parë i këtij programi.

Në plotësim të misionit :- **“Buxhet i balancuar, Zhvillim i Qëndrueshëm”** kemi planifikuar fondet e nevojshme me prioritet mbështetur në këto shtylla kryesore:

- a) **Shërbime Publike** cilësore dhe të shtuara nga ana sasiore.
- b) **Vëmendje të plotë për Arsimin** e për permiresimin e infrastrukturës, *për një Berat - qytet të fëmijëve.*
- c) **Zhvillim Kulturor** me impakt të rëndësishëm social.
- d) Investim në **infrastrukture bujqesore.**

Objektivi i përgjithshëm i buxhetit 2020 : Menaxhimi korrekt i financave vendore, sigurimi i përdorimit të fondeve publike në respektim të parimeve të ekonomizimit, efikasitetit dhe efektivitetit, **në funksion të realizimit të misionit të Bashkisë**, dhe në zbatim të VKB, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe PBA Përfundimtare 2020-2022”, por jo vetëm.

Ndër objektivat e rëndësishëm të tij citojmë:

1. **Realizimi i planit të të ardhurave vendore, të planifikuara në zbatim të paketën e re fiskale**, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak më, 18 dhjetor 2019.

Në Shërbimet publike vendore:

2. **Mirëmbajtjen e të gjithë hapësirave urabne** në të gjithë territorin e bashkisë si dhe mirëmbajtjen e rrugëve rurale në inventarin e bashkisë, **shtimi me 3,400 m² segmente rrugore me kalldrëm, sheshe me pllakë trotuari 770 m², ndërtim segmente rrugesh me beton** në pjesë të ndryshme me prioritet emërgjencën dhe kërkesën e komunitetit të Bashkisë Berat dhe kryesisht:
 - Njesia Administrative Otlak **340 m²**
 - Rruga Kostandin Berati Rajoni Nr. 3, për 1000 m²
3. **Mirëmbajtja e rrjetit ekzistues të ndriçimit publik**, dhe shtimin e tij për të mundësuar mbulimin i zonave të reja me ndriçim. Objektivi Shtimi i rrjetit të ndriçimit publik me 1.5 km.



-
4. **Mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore.**
 5. **Rritjen e hapësirave të gjelbërta** nëpërmjet kyerjes së të gjitha shërbimeve teknologjike në parqet ekzistuese, shtimit të sipërfaqeve me lule sezonale dhe mbjelljes së pemeve e drurëve dekorativ të reja.
 6. **Krijimi i 7 hapësirave të gjelbërta në lagjet :**
 - a. Parku Dëshmorët e Kombit (ish këndi i lojrave) me sipërfaqe **816 m²**
 - b. Pranë Shkollës M. A. Vrioni me sipërfaqe **420 m²**
 - c. Para Ndërmarrjes së Gjellbërimit me sipërfaqe **70 m²**
 - d. Pranë Tregut të përgjithshëm Çlirim, me Sipërfaqe **126 m²**,
 - e. Pranë rrugës së re të Velabishtit me sipërfaqe **500 m²**
 - f. Para sigurimeve shoqërore me Sipërfaqja **300 m²**
 - g. Pranë TV Onufri me sipërfaqe **196 m²**

Në arsimin parashkollor, parauniversitar:
 3. **Përmirësimin e infrastrukturës arsimore, duke përfshirë kopshte, shkollat 9-vjecare, arsimin e mesëm të përgjithshëm, konviktet,** nëpërmjet mirëmbajtjes së institucioneve arsimore në gjithë territorin e bashkisë si dhe rinovim të paisjeve për cerdhet dhe kopështet.
Ne aspektin social:
 4. Përfshirja në skemën e përfitimit të **subvencionim të qirasë** në tregun e lirë **familjeve për 35 familje me probleme sociale dhe ekonomike** konkretisht familjet që kanë persona me aftësi të kufizuar në përbërjen familjare, gratë e divorcuara me fëmijë në ngarkim dhe familjet me të ardhura familjare mujore shumë të ulëta.
 5. Përfshirja në skemën e **subvencionim të qirasë të 48 familjeve të strehuara** në banesat sociale të bashkisë të cilat janë në kushte të vështira sociale dhe ekonomike.
 6. Bashkia Berat për herë të **parë do të mbulojë interesat e kredise për 100 familje të pastreha** sipas akt-marrëveshjes që do të lidhë me bankat, kryesisht familje të reja me të ardhura familjare mujore mesatare
 7. **Përrjashtimi nga tarifa mujore e pagesës ushqimore në kopështe/cerdhe** të fëmijëve prej: komunitetit rom/egjyptian, fëmijë të familjarëve përfitues të ndihmës ekonomike, të nënave kryefamiljare, fëmijë me aftësi ndryshe dhe të diagnostikuar me sëmundje terminale, të vërtetuar nga KMCAP.
Sherbimet publike të kontraktuara:
 8. **Të realizojë shërbim të menaxhimit të mbetjeve urbane efektiv dhe eficient,** për të gjithë zonën ku ka akses kontrata e sipërmarrjes së këtij shërbimi, nëpërmjet një sistemi më efikas të matjes dhe monitorimit të tij.
 9. **Rritje e performancës së ofrimit të shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike** dhe të dëshmorëve , nëpërmjet një sistemi më efikas të matjes dhe monitorimit, ofrimit të shërbimit të standartizuar për varrezat publike
 10. Vlerësimi i nevojave për zgjerim territori për varreza.
Ne aspektin kulturor dhe sportive.
-



11. **Gjallerimin e jetes social - kulturore dhe artistike nëpërmjet mbështetjes financiare të aktiviteteve sociale, kulturore dhe sportive në qytet** ne bashkëpunim edhe me donator dhe partner vendas dhe të huaj.
12. **Harmonizimin dhe përfshirje të kërkesave** të komunitetit të dala nga dëgjesat publike me planet sektoriale të bashkise dhe të ndermarrjeve e institucioneve në vartesi të saj.
13. **Mirëmbajtje dhe pastrim i rrjetit të ujitjes dhe kullimit** duke siguruar rritjen e cilesise se shërbimit për fermerë të lidhur.
14. **Rehabilitimi dhe rikonstruksioni i infrastruktures se ujitjes dhe kullimit** dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja në zonat e banuara.
15. **Mbrojtja dhe rritja e sipërfaqeve pyjore/ kullosore/ shërbimi pyjor** sipas mënyrës së përcaktuar në ligj.
16. **Likudjimin brenda vitit 2020 te 83% borxhit progresiv**, te vitit 2019 i përbërë nga fatura të administruara nga bashkia dhe ndermarrjet e vartesisë. Pjesa tjetër prej 17% do te likujdohet ne buxhetin e vitit 2021.

Fokusi I punes sone gjate vitit 2020 synon:

1. **Forcimin e disiplinës fiskale**, në plotësim të rregullave dhe parimeve të sanksionuara me ligj në hartimin, konsultimin, miratimin, e të ardhurave gërshtuar kjo me një menaxhim të shëndoshë financiar.
2. **Motivimin dhe angazhimin maksimal të administratës së bashkise për plotësim të planit e të ardhurave.**
3. **Maksimalizimin lufës kundër evazionit fiskal gërshtuar kjo me rritjen e partneritetit biznes - pushtet vëndor** për krijuar premisa reale në këtë sfidë për konkurueshmëri gjithnjë e më reale.
4. **Planifikimi korrekt dhe profesional do të shoqërohet me masa konkrete të mirëprogramuara për të siguruar efektivitet maksimal për të gjitha të ardhurave me vëmëndje të shtuar ndaj pronave bashkiake**, dhe të ardhurave që krijojnë Drejtoritë në strukturën e administratës së bashkisë.
5. **Ritjen e efektivitetit ekonomik të kostos së shërbimeve publike** me sipërmarrje dhe mbulimin e shërbimeve të shtuara me kapacitetet e vetë Bashkisë.
6. **Rritja e gadishmërise nëpërmjet marrjes së masave paraprake organizative, manaxheriale e materiale** për përballimin e emergjencave civile.
7. **Pergjigjen e menjëhershme për dhënien e ndihmës në raste fatkeqësish** sipas akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi.
8. **Gjetja e hapësirave të mundshme me objektiv uljen e numrit të familjeve të pastreha** nëpërmjet implementimit të projekteve dhe marrveshjeve me partnerë të biznesit privat sikurse janë bankat e nivelit të dytë për mundësinë e implementimit të projektit për kreditë e buta.
9. **Për herë të parë trajtojmë zonat depressive ekonomike duke stimuluar zhvillim ekonomik nëpërmjet krijimit të lehtësirav fiskale në to.**
10. **Riaktivizimin e kapitaleve të heshtura duke adresuar nxitës fiskal për aktivizimin e tyre.**



11. **Përditesim korrekt të të dhënave për familjet me probleme sociale dhe ekonomike** me vëmendje të shtuar - familjet që kanë me persona me aftësi të kufizuar në përbërjen familjare, gratë e divorcuara me fëmijë në ngarkim dhe familjet me të ardhura familjare mujore shumë të ulëta, **per te perftuar nga skemat per strehim social dhe gjithë lehtësirat fiskale që i ofron paketa e re.**
12. **Të forcojë dy mekanizma shërbimesh:** Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Dhunës me Bazë gjinore, duke synuar mbrojtje të vecantë të të drejtave të fëmijëve nëpërmjet marrjes së masave për ti siguruar ushtrimin e të drejtave të tyre brenda kuadrit ligjor, bashkëpunimit midis strukturave dhe autoriteteve qendrore e lokale
13. **Permiresimin e shërbimit të transportit** duke synuar nje përjasje te integruar ne zhvillimin dhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve, në mbrojtje të ambientit, një transporti i qëndrueshëm, i besueshëm dhe me mjete që duhet të përmiresohen duke ju përafruar standarteve të Komunitetit Europian.
14. Shfrytëzimin në mënyrë të **qëndrueshme të fondit pyjor** dhe kullosor dhe mirëadministrimin e tyre për të krijuar mbështetje reale për këtë sektor të rendësishëm ekonomik.
15. Monitorim, kontroll dhe kujdes të shtuar **për inspektimin e produkteve blegtorale**, kryesisht produktet e mishit, si dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për tregtimin e produkteve nëpërmjet mirëadministrim të tregjeve ku ofrohen këto produkte.

1.3 INFORMACION PËRMBLEDHËS PËR PËRGATITJEN E BUXHETIT TË VITIT 2020 DHE PBA 2020 -2022.

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr 23 date 30.07.2018, ‘Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njesive të qeverisjes vendore’, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 7 datë 27.02.2019 ‘Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022’, u ngrit Grupi për Menaxhim Strategjik me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 207 Date 07.03.2019 si dhe Ekipet e Menaxhimit të Programit, u përgatit Udhëzimi për përgatitjen e PBA 2020-2022 me nr. 1622 prot. date 25.03.2019 dhe u vu në dispozicion të Grupit për Menaxhim Strategjik dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programit.

Neni 37 i ligjit ‘Për financat e vetëqeverisjes vendore’, citon: Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, të përcaktuara në udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit vendor të Ministrisë së Financave, kryetari i njësive të vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në keshillin e njësive të vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.

Në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 36, si dhe të Kalendarit Buxhetor për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, Bashkia Berat përgatiti fazën e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022. U miratua me Vendim të Keshillit Bashkiak nr. 50 date



19.03.2019 ‘Vlerësimet afatmesme 2020-2022 të të ardhurave’ si dhe me VKB nr. 51 date 19.03.2019 “Tavanet përgatitore të PBA 2020-2022” .

U përgatit dhe u miratua drafti parë në Këshillin Bashkiak me Vendimin nr. 96 date 19.06.2019.

Bashkia Berat ka depozituar pranë Ministrise se Financave dhe Ekonomise projekt-dokumentit e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm, me shkresën nr. 2980 prot. date 31.05.2019.

Pas ndryshimeve që sollen zgjedhjet e 30 qershorit rikonfiguruar me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.632 dt.04.09.2019, **Grupin për Menaxhimin Strategjik (GMS)** si dhe **Ekipet e Menaxhimit të Programeve të Shpenzimeve**.

Për të finalizuar procesin dhe përgatitur draftin e rishikuar u përgatit Plani i Masave dhe Veprimet me nr. 3792/2 prot date 03.09.2019, ku janë të percaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjes.

Plani i veprimeve, proces verbalët e degjësive publike si dhe lista e pjesëmarrësve janë pjesë e dokumenteve të përgatitjes dhe miratimit të PBA 2020-2022.

Sipas grafikut të programuar zhvilloi degjësat publike me lagjet Nr.1.2.3 në Berat, Njësiti administrativ Otllak , Sinje, Velabisht, Roshnik, me grupet e interesit dhe komunitetin, **duke tërhequr mendimet, kërkesat e sygjerimet e tyre**.

Në këtë kuadër u kryen këto aktivitete:

Aktiviteti nr. 1 - Organizimi i degjësive publike me komunitetin në lagjet e qytetit dhe kater njësiti administrativ.

Aktiviteti nr. 2 - Organizimi i degjësive publike me grupet e interesit.

Aktiviteti nr. 3 - Zhvillim i degjësive publike me komunitetin në lagjet e qytetit , njësiti administrativ dhe grupet e interesit:

Aktiviteti nr. 4 - Miratimi i dokumentit të rishikuar të PBA 2020-2022.

1. Përgatitja e materialit të rishikuar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020 -2022, Miratimi në Këshillin Bashkiak
2. Dërgimi i materialit të këtyre aktiviteteve në Ministrinë e Financave, brenda 15 shtatorit 2019.

Propozimet e tërhequra nga komuniteti dhe grupet e interesit u administruan nga GMS dhe sipas problematikave u adresuan Ndërmarrjeve të vartësive së bashkisë, si dhe Sh.A.Ujesjelles-Kanalizime Berat - Kucove, për t'i integruar në programet përkatëse buxhetore, sipas listimit të prioriteteve brenda mundësive financiare.

Disa nga problematikat të marra nga informacionet e përgatitura nga organizimi i degjësive në cdo njësi administrative, lagjet e qytetit dhe grupet e interesit: (në mënyrë të detajuar janë në proces verbalët e takimeve pjesë përbërëse e dosjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, faza e rishikuar)

Ndërmarrja e Shërbime Publike administroi problemet që kanë të bëjnë me:



Bashkia Berat

- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore në akset dytësore të lagjeve të qytetit dhe të Njësive Administrative.
- Funkcionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit atje ku ky rrjet ekziston, dhe përpjekje për shtimin atje ku është me e domosdoshme, duke përfshirë jo vetëm lagjet e qytetit dhe qendrat e njësive administrative por edhe fshatra.
- Përmirësim i sinjalistikës rrugore etj.

Drejtoria e Arsimit e Bashkisë administroi problemet që kanë të bëjnë me:

Përmirësimi i gjithë infrastrukturës në shkollat e qytetit dhe njësive administrative përfshi rrjetin elektrik, hidraulik, për ngrohje, kënde sportive, etj.
Përmirësimin e infrastrukturës në çerdhe, kopshte.

Drejtoria e Bujqësisë administroi problemet që kanë të bëjnë me:

- Vënien në funksion të plotë të kanaleve kulluese dhe vaditëse në njësitet administrative;
- Hapja e kanaleve të dyta për vaditjen e tokave.
- Zgjidhjen e problemit të rrugëve në parcelat bujqësore, etj.

Ndërmarrja e Gjellbërimit administroi problemet që kanë të bëjnë me:

- Mirëmbajtje dhe shtimin e sipërfaqeve të gjelbra, sidomos në hapësirat midis blloqeve të banimit,
- Shtimin të mbjelljes së pemëve dhe drurëve dekorativ.
- Rikthimin e vlerave të qytetit të Beratit si qytet i luleve nëpërmjet zëvendësimit stinor të tyre.
- Krijimin e këndeve çlodhëse, argëtuese në zona të ndryshme të territorit të Bashkisë;

Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Berat - Kucove, administroi problemet që kanë të bëjnë me:

- Përmirësimin e rrjetit të ujësjetës – kanalizimeve, duke reduktuar kufizimet e duke përmirësuar rrjetin e shpërndarjes;

Bashkia Berat ka hartuar Programin Buxhetor Afatmesëm në përputhje me standartet bashkëkohore duke u mbështetur në trajnimet e specialistëve të financës, tatim - taksave, shërbimeve publike, planifikimit të territorit, burimeve njerezore, prokurimeve etj. , të realizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASP), të organizuara nga Ministria e Financës.

Gjithashtu ndihme e vyer ka qenë bashkëpunimi me **Projektin “Financat Lokale”**, i cili financohet nga Qeveria Zviceriane dhe zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, në 15 Bashki, përfshirë dhe Bashkinë Berat.

Në vitin 2019 Bashkia (specialistët e financës së bashkisë e të njësive shpenzuese) u asistua nga ekspertët të Projektit: “Financat Lokale”, që lehtësuan procesin e përgatitjes së PBA në funksion të kërkesave të reja ligjore. Për çdo ndërhyrje, Bashkia Berat ka zhvilluar një program buxhetor për të cilin ka identifikuar burimet që do të përdoren për të realizuar projektet.

Të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave janë marrë duke analizuar:

- ✓ Treguesit e realizuar në vitet 2017,2018.



-
- ✓ Planifikimin dhe pritshmeritë e vitit aktual 2019.
 - ✓ Vlerësimin real të burimeve të të ardhurave implementim të paketes se re fiskale.
 - ✓ Likudjimin brenda vitit 2020 të borxhit progresiv të vitit 2019 i përbërë nga fatura të administruara nga bashkia dhe ndërmarrjet e vartësisë.

Ministria e Financave dhe Ekonomise ka konstatuar se: Bashkia Berat ka respektuar standartet e percaktuara ne *Udhëzimin e Ministrit te Financave dhe Ekonomise nr 23 date 30.07.2018, 'Per procedurat standarde te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te njesive te qeverisjes vendore', si dhe Udhëzimin e Ministrit te Financave dhe Ekonomise nr. 7 date 27.02.2019 'Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem 2020-2022', ku percaktohen se pjese e dokumentit te hartimit te PBA jane; pema e programit buxhetor, Relacioni shpjegues, Formatete outpute e Instrumentit Planifikimit Financiar dhe treguesit e performances.*

- Projektdokumentit i Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, të Bashkisë Berat është përgatitur ne Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT);
- Bashkia Berat ka depozituar prane MFE project dokumentit e pare të Programit Buxhetor Afatmesëm, me shkresen nr. 2980 Prot. Date 31.05.2019.
- Raportet e projektdokumentit te PBA-së, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, janë sipas formateve te përcaktuara ne udhëzimin plotësues;

Ministria e Finances dhe Ekonomise ka vleresuar angazhimin e Bashkise Berat ne permiresimin e procesit te hartimit te Programit Buxhetor Afatmesem, duke e kthyer PBA-ne, ne nje mjet te realizimit te Strategjive se Zhvillimit. Mirepecaktimi i Qellimeve, Objektivave dhe Produkteve per cdo program buxhetor me tregues te matshem si dhe planifikimi i shpenzimeve mbi baze kosto per njesi produkti, bejne te mundur realizmin e Planit Stategjik te Zhvillimit.

Rekomandim i dhene :

Ekipet e Menaxhimit te Programit te parashikojne produkte me terma te matshem per cdo objektiv, si dhe te planifikojne shpenzime mbi baze te kostove per njesi produkti.

Bashkia Berat ne periudhen tetor- nentor ne procesin e përgatitjes se Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, nga cdo njesi shpenzuese dhe per cdo program buxhetor ka marrë marre ne konsiderate kete rekomandim.

Bashkia Berat ka zhvilluar programe buxhetore për të cilin ka identifikuar burimet që do të përdoren për të realizuar projektet.

PBA është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe shqetësimeve të drejtpërdrejta të komunitetit, të evidentuara :

- I. Nga takimet e Kryetarit të Bashkisë me qytetarë.
- II. Gjatë punës sonë të përditëshme në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.
- III. Nga kërkesat dhe ankesat e qytetareve adresuar administratoreve te lagjeve dhe njesive administrative.



IV. Nga degjesat publike organizuar pas fazes se pare te pergatitjes se PBA.

Viti 2020 është viti i pare i PBA 2020 -2022 , ne këtë kontekst kërkesat buxhetore të vitit 2020 jane te harmonizuara me politikat dhe objektivat afatmesme 2020-2022.

Në dokumentin e PBA-së të Bashkisë Berat shpërndarja e burimeve është realizuar mbi bazë programi buxhetor dhe totali i tavanëve të shpenzimeve është brënda kontekstit të të ardhura vetë parashikuara. Parashikimi buxhetor është i balancur.

Dokumentet, mbi te cilët është mbështetur hartimi i Programi Buxhetor Afatmesëm dhe buxheti vjetor 2020 jone:

- i. Programi qeverises i Kryetarit te Bashkise per periudhen 2019-2023.
- ii. Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkise
- iii. Strategjia dhe Plani i Veprimit i Turizmit
- iv. Strategjitë sektoriale qe janë te lidhura me kompetencat e pushtetit vendor

2. PARASHIKIMET BUXHETORE AFATMESME 2020-2022

2.1 PLANI FINANCIAR I PERIUDHES AFATMESME 2020-2022

Bashkia Berat, si burimi financimi të shpenzimeve vendore për vitin 2020 dhe PBA 2020-2022 do të kete:

- i. Të ardhurave vendore te planifikuara (Plani i te ardhurave vendore gjithesej)
- ii. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme (e perbere nga transferta e pakushtezuar dhe transferta sektoriale per funksionet e deleguara)

Skema e financimit të funksioneve të reja të transferuara në njesitë e qeverisjes vendore në vitin 2016, dhe të financuara me transfertë specifike (sektoriale), në buxhetin e vitit 2020 do te vijoj të jetë transfertë e pakushtëzuar për sektorë të veçantë.

Në dokumentin e PBA-së të Bashkisë Berat shpërndarja e burimeve është realizuar mbi bazë programi buxhetor dhe totali i tavanëve të shpenzimeve është brënda kontekstit të të ardhurave të parashikuara. *Parashikimi buxhetor është i balancur.*



Bashkia Berat

PASQYRË PËRMBEDHËSE E BUXHETIT TË VITIT 2020 KUNDREJT PARASHIKIMIT TË VITIT 2019.

000/ leke

Nr.	Pershkrimi	Buxheti fillestar 2019	Pesha Specif. ne %	Buxheti i rishikuar 2019	Pesh a Speci f. ne %	Buxheti I planifikuar 2020	Pesha Specifike ne %
I	Totali i te ardhurave	1,036,051	100	1,163,760	100	1,075,270	100
1	Total Transferta	537,085	52	637,893	55	547,061	51
a	Transferta e pakushtezuar	285,474	28	285,474	25	293,099	24
b	Trans. e pakushtezuar trashëguar nga viti paraardhës	0	0	46,679	4		0
c	Transferta Specifike	251,611	24	253,727	22	253,962	27
D	Trans. e Specifike trashëguar nga viti paraardhës	0	0	52,013	4		0
2	Total te ardhura te veta	498,966	48	525,867	45	528,209	49
a	Te ardhura te veta	498,966	48	503,966	43	528,209	49
b	Te ardhura te veta tarshëguar nga viti paraardhës	0	0	21,901	2		0
II	Totali i Shpenzimeve	1,036,051	100	1,163,669	100	1,075,270	100
1	Totali shpenzime operative (korrente)	766,951	74	791,298	68	901,816	84
a	Shpenzime personeli	499,150	48	508,176	44	514,286	48
b	Shp.operative, & mirembajtjes& te tjera transfert	267,801	26	283,122	24	387,530	37
2	Shpenzime kapitale	269,100	26	372,371	32	173,454	16

Ne pasqyren e mesiperme shihet qarte peshas specifike te te ardhurave dhe shpenzimeve te vitit 2020 kundrejt parashikimit te vitit 2019.

PLANI FINANCIAR I BASHKISE BERAT PER PERIUDHEN AFATMESME 2020-2022

Nr.	Pershkrimi	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
I	Totali i te ardhurave	1,075,270	1,127,280	1,164,485
1	Total Transferta	547,061	583,225	604,108
a	Transferta e pakushtezuar	293,099	329,263	350,146
b	Transferta Specifike	253,962	253,962	253,962
2	Total te ardhura te veta	528,209	544,055	560,377
a	Te ardhura te veta	528,209	544,055	560,377
II	Totali i Shpenzimeve	1,075,270	1,127,280	1,164,485
1	Totali shpenzime operative (korrente)	901,816	919,715	950,693
a	Shpenzime personeli	514,286	517,653	536,569
b	Shp.operative, & mirembajtjes& te tjera transfert	387,530	402,062	414,124
2	Shpenzime kapitale	173,454	207,565	213,792

**TREGUES TE BUXHETETIT 2020/2019 :**

Treguesit kyc financiar	Buxheti 2019	Buxheti 2020
1. Shpenzime te pergjithshme / te ardhurave te pergjitheshme	100%	100%
2. Taksa + tarifa vendore /totalit te te ardhurave	67%	76%
3.Te ardhura te veta / totalit te te ardhurave	48%	49%
4. Shpenzime kapitale / totalit te shpenzimeve	26%	16%
5.Shpenzime korrente / totalit te shpenzimeve	74%	84%
6. Shpenzime personeli / shpenzimeve te pergjitheshme	48%	48%
7.Shpenzime operative / totalit te shpenzimeve	26%	37%
8. Shpenzime te detyrim.prapambetura /total shpenzime. vjetore	4%	14%
9. Shpenzime te politikave sociale/ totalit te shpenzimeve	6%	6.4%

2.2 TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E VITIT 2020 DHE FORMULA E SHPËRNDARJES SË SAJ

Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit është e ardhur për njësitë e qeverisjes vendore, e përfituar në formën e dhurimit pa kusht kthimi, pa interes, e cila përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet e veta dhe të përbashkëta të njësive të qeverisjes vendore, të përcaktuara në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2020, bazohet në një formulë të thjeshtë për t’u kuptuar dhe zbatuar, të bazuar në kritere që garantojnë funksionimin normal të njësive të vetëqeverisjes vendore. Transferta e pakushtëzuar do t’u sigurojë njësive të vetëqeverisjes vendore mbulimin e diferencës mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur.

Për vitin 2020, transferta e pakushtëzuar përbëhet nga dy pjesë: a) pjesa e përgjithshme dhe b) pjesa sektoriale. Mekanizmi i shpërndarjes së transfertës është i përshtatur në funksion të reformës administrativo-territoriale.

Ndarja e grantit bazohet plotësisht në formulë, pa përfshirë fondet për konviktet, shërbimet sociale, fondet e rrugëve rurale. Gjithashtu, formula e shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar tek:

- popullsia relative,
- dendësia e popullsisë (që reflekton diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) .
- numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki.

